



Sigurimi i Pronës

Sigurimi i pronës mbron interesat e klientëve kredimarrës pranë Alpha Bank Albania dhe klientëve jo kredimarrës pranë Alpha Bank Albania, në rast ndodhje dëmi të pasurisë së siguruar nga rreziqe bazë si Zjarri dhe Tërmeti.

Karakteristikat e Sigurimit të Pronave:

Sigurimi i pronës ofrohet për të gjithë klientët të cilët janë të interesuar të sigurojnë pronat e tyre me sigurimet bazë nga zjarri dhe tërmeti, si dhe mbulime të tjera shtesë sipas kërkesës së klientit.

1. **Sigurimi i Pronës për Huanë** mbron interesat e klientëve kredimarrës të Alpha Bank Albania në rastet e dëmtimit të pasurisë, e vendosur si kolateral pranë Bankës.
2. **Sigurimi i Pronës Vullnetare** mbron interesat e klientëve në rastet e dëmtimit të pasurisë.

I Siguruari mund të jetë çdo individ ose person juridik, të cilët kanë interes pasuror mbi objektin që do të sigurohet.

Shuma e sigurimit përcaktohet në policë sipas kritereve të përcakutara nga Banka ose Klienti:

1. **Vlera e zëvendësimit**, sipas kushteve të Punës të shpallura në faqen zyrtare të Bankës
2. **Vlera e tregut** sipas raportit të vlerësimit ose çmimeve referencë të tregut të pasurive të paluajtshme
3. **Vlerën e mbetur** e kredisë sipas planit të amortizimit

Primi i sigurimit të pronës llogaritet sipas vlerës së pasurisë, llojet e mbulimit të përzgjedhur dhe paguhet çdo vit.

Kohëzgjatja e sigurimit të pronës është e vlefshme për një vit dhe e rinovueshme.

Përfituesi i policës së sigurimit përcaktohet në policë.

Dëmshpërblimi paguhet nga Kompania e Sigurimit në rast vërtetimi të ngjarjes së siguruar, duke e rikthyer objektin në gjendjen e mëparshme ose pagesë në vlerë monetare.

Pjesa e zbritshme është risku i mbajtur nga i Siguruari në rast dëmi. Për çdo rast dëmi, Siguruesi do të zbresë nga dëmshpërblimi i llogaritur pjesën e zbritshme të përcaktuar në Policën e Sigurimit në shumë absolute ose në përqindje.

Në rastin e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit, i Siguruari duhet:

- Të njoftojë menjëherë me shkrim Siguruesin dhe të njoftojë organet e rendit e njësite zjarrfikëse, brenda 72 orëve;
- Nëse është e mundur, të mos ndryshojë asgjë në vendngjarje pa miratimin e Siguruesit;
- T'i dorëzojë Siguruesit brenda 10 diteve një listë të firmosur të të gjitha objekteve të dëmtuara.

Dokumentacioni që plotësohet:

- Karta e identitetit të klientit
- Çertifikata e Pronës